REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2020:073288

Datë: 12.09.2022

Numri i dokumentit: 03412348

C. nr. 72/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me referenten e lartë Mimoza Mehmeti, në qështjen kontestuese të paditësit B. K. e S. (...), rr. "L. e P." p.n, në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson Njomza Bogiqi nga Prishtina, kundër të paditurit B. (J.) D. nga fshati K. e E., për shkak të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, jashtë séances gjyqësore, me date 12.09.2022 merr këtë,

A K T V E N D I M

I.Pranohet marrveshja per zgjidhje të ndërmjetësuar, e arritur pranë Qendrës së Ndërmjetësimit në Gjilan, e datës ..., në qështjen kontestimore C.nr. 72/20, të paditëses B. K. e S.t (...), rr. "L. e P." p.n, në Fushë Kosovë, kundër të paditurit, B. (J.) D. nga fshati K. e E.e, rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, në shumë prej 927.00 €, (nëntëqindë e njëzet e shtatë euro).

II. Secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi B. K. e S. (...), rr. "L. e P." p.n, në Fushë Kosovë, në këtë gjykatë më datën 22., ka ushtruar padi ndaj të paditurit , B. (J.) D. nga fshati K. e E., për pagimin e borxhit në shumë prej 927,00 €.

Në pajtim me nenin 9.5 dhe 9.6 te Ligjit mbi Ndermjetësimin , rasti i është derguar për zgjidhje paqësore Qendrës së Ndërmjetësimit ne Gjilan , të cilet këtë rast e kanë zgjidhur sipas nenit 12 te Ligjit mbi Ndërmjetësimin, ashtu që rastin e zgjidhur me ndërmjetsim të datës ..., ia kanë dërguar gjykatës për aprovim.

Gjykata konstatoi faktin se rasti i zgjidhur me ndërmjetësim, i plotëson kushtet ligjore për tu aprovuar nga gjykata, pasi që palët lirisht mund të disponojnë me të drejtat për të cilat janë marrë vesh në zgjidhjen e rastit.

Vendimi mbi shpenzimet u muar ne kuptim te nenit 452.2 të LPK.

2020:073289

Nga të cekurat më lartë, e konform nenit 411.1 te LPK dhe nenit 12 te Ligjit mbi Ndërmjetsimin nr. 03/L-057, gjykata vendosi si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 72/20, Më date 12.09.2022

Gjyqtari
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.